

 <b>REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO</b> <b>QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT</b> <b>MINISTRIA E EKONOMISË</b> <b>MINISTARSTVO EKONOMIJE</b> <b>MINISTRY OF ECONOMY</b>	
Njësia Org. Org. Jedin Org Unit Nr. i fagave Broj stranica No. pages	0113
Nr. Prof. Br. Prof Prof.No: Dritë: Datum: Date:	2745
	18.03.24
PRISHTINË/A NO. 1	



NËDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

**N.H. VP. "IBËR-LEPENC" SH.A.**

01- 899 Dt. 18.03.2024  
PRISHTINË-PRIŠTINA

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Priština, Kosovo  
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

## Raporti vjetor për vitin 2023

Bordi i Drejtoreve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.02.2024, pas shqyrtimit të raportit vjetor për vitin 2023 mbi zhvillimet e aktiviteteve afariste në NPH "Ibër Lepenc" Sh.A, mori vendimin për miratimin e këtij rapporti dhe kërkoj që i njëjti rapport të përcillet në NJPMNP.

	<b>Delegoi</b>	<b>Aprovoi</b>
Emri Mbiemri	Kryeshef Ekzekutiv	Kryesuesi i Bordit të Drejtoreve
Nënshkrimi	<b>Faruk MUJKA</b>	<b>Bajram MUSTAFA</b>
Data: 18.03.2024		





NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.  
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.  
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Për: **BORDIN E DREJTORËVE TË N.H."IBER-LEPENC", SH.A. PRISHTINË**  
Nga: **KRYESHEFI EKZEKUTIV N.H."IBER-LEPENC", SH.A. PRISHTINË**  
Lënda: **RAPORTI VJETOR I PUNËS - 2023**  
Data: **27.02.2024**

## **RAPORTI VJETOR I PUNËS – 2023 N.H."IBER-LEPENC"**

Prishtinë, Shkurt

2024

## PËRMBAJTJA:

1. Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv të NH “Ibër-Lepenc” .....	3
2. RAPORTI I PUNËS SË KRYESHEFIT EKZEKUTIV .....	5
2.1 Ngjarjet kryesore të vitit .....	5
3. RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2023 NGA AUDITORI I BRENDËSHËM .....	8
4. TË HYRAT NGA UJI DHE GJENERIMI .....	16
5. DEPARTAMENTI I FINANCAVE.....	31
Hyrje.....	31
Aktivitetet Kryesore të Ndërmarrjes.....	33
5.1 Gjenerimi i Energjisë Elektrike .....	35
5.2 Distribuimi i Ujit .....	35
5.3 Ujitja.....	36
5.4 Të Hyrat.....	37
5.5 Të Hyrat nga Energjia Elektrike .....	38
5.6 Të Hyrat nga Uji.....	38
5.7 Të Hyrat nga Ujitja .....	39
5.8 Të Hyrat Tjera.....	40
5.9 Shpenzimet .....	40
5.10 Konkluzion.....	41
6. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT .....	42
7. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	45
8. ZYRA LIGJORE .....	47
9. DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM .....	57
10. NJESIA IMPLEMENTUESE e WSCP .....	62
10.1 HISTORIKU.....	62
Prezantimi .....	62
PROGRESI SIPAS KOMPONENTEVE .....	67
Komponenti 1: Rehabilitimi dhe Modernizimi i Infrastrukturës.....	67
10.2 Çështjet e Menaxhimit Financiar .....	69
10.3 Çështjet e Prokurimit dhe Menaxhimit të Kontratës.....	70

10.4 RAPORTI I SIGURIVE .....	72
Masat Mbrojtëse Mjedisore dhe Sociale .....	72

## 1. Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv të NH “Ibër-Lepenc”

Prioritetet tona për të ardhmen mbeten të fokusuara në ofrimin e shërbimeve sa më kualitative, mirëmbajtjen dhe operimin e infarstrukturës ekzistuese, rehabilitimin dhe zgjerimin e kapaciteteve, investime kapitale në përputhje me politikat qeveritare për menaxhimin efikas të ujit si dhe rritjen e të hyrave financiare.

Në Planin strategjik zgjerimi i ndërmarrjes në aspektin e aseteve si dhe në aspektin e veprimtarisë mbeten si qëllim. Specifiksht, prioritet në zhvillimin e afarizmit të ndërmarrjes do të jenë:

- Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe plotësimi në vazhdimësi i kërkesave për klientët tonë,
- Mirëmbajtja e aseteve kryesore ekzistuese, rritja e investimeve kapitale në mënyrë të vazhdueshme dhe afatgjate.
- Rehabilitimi dhe modernizimi i Hidrocentralit në tërësi, rehabilitimi i kanalit kryesor, automatizimi i tërësishëm i sistemit të komandimit dhe monitorimit të objekteve të ndërmarrjes, digitalizimi i sistemit të N.H.”Ibër-Lepenc” nëpërmjet projektit SCADA.
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Bankën Botërore në projektet e përbashkëta në hartimin e studimit të fizibilitetit me qëllim të rritjes së kapaciteteve të prodhimit të rrymës, nëpërmes panelevë solare apo rritjes së kapacitetit të stabilimenteve tona në HC e Ujmanit.
- Bashkëpunimi sa më i ngushtë me MMPHI, BERZH dhe WBIF në fillimin e realizimit të projektit të Lepencit.

Përkundër sfidave, viti 2023 konsiderojmë se ishte vit i suksesshëm afarist, duke ju falemnderuar angazhimit të gjithë të punësuarve, stafit menaxherial, zyrtarëve të lartë, qeverisjes profesionale koorporative nga ana e Bordit të drejtoreve, si dhe mbështetjes institucionale nga aksionari (Qeveria e Republikës së Kosovës).

Edhe këtë vit jemi përballur me shumë probleme dhe vështirësi duke përfshirë këtu edhe problemet me ndërtim në afërsi dhe mbi sistemin e ujitjes, të cilat kanë ndikuar që ujita të mos realizohet në mundësitetë dhe kapacitet që ndërmarrja posedon. Sa i përket ndërtimeve mbi dhe afër kanalit kryesor që evidentohen si pronë e ndërrmarjes sonë, ato janë në proces gjyggësor, ndërsa sa i përket tjetërsimit të pronave bujqësore në toka ndërtimore është përgjegjësi e komunave përkatëse dhe pronarëve të parcelave.

Vështirësi më të theksuara kanë qenë: ndërrimi i destinacionit të tokave bujqësore me infrastrukturë të ujites, respektivisht shëndrrimi i tokave bujqësore në ato ndërtimore kyçjet e përnjëhershme të fermerëve në sistemin e ujites, dëmtimi i gypave dhe fazonerisë nga keqbërës të ndryshëm, zbrazja e ujërave të zeza në kanalet e ujites, ndërtimet mbi sistemin e ujites si dhe toka bujqësore e ngelur djerrinë (të pa punuara) nën sistemet e ujites.

Sfiduese ka qenë poashtu hartimi i rregulloreve për strukturën organizative të ndërmarrjes dhe ai për sitematzimin e vendeve të punës dhe jetësimi i tyre në praktikë.

Sa i përket anës financiare, kemi realizuar performancë pozitive, kryesisht nga prodhimi i energjisë elektrike e që ka ndikuar që obligimet dhe shërbimet ndaj klientëve dhe operatorëve ekonomik të kryhen në kohë, më cilësi dhe sasi të nevojshme për të plotësuar kërkuesat e tyre dhe pritshmëritë e ndërmarrjes sonë.

Viti në vazhdim do të jetë vit i investimeve kapitale në infrastrukturën tonë, pështatjes sa më të mirë të menaxhimit të shitjes së energjisë elektrike në platmormën e re të bursës së përbashkët të Kosovës dhe Shqipërise "ALPEX" dhe funksionimi i plotë i ndërmarrjes sipas organogramit të aprovuar me 31.10.2023

Kryeshefi Ekzekutiv

Faruk Mujka  
N.P.H. " Iber-Lepenc" Sh.A Prishtinë

## 2. RAPORTI I PUNËS SË KRYESHEFIT EKZEKUTIV

### 2.1 Ngjarjet kryesore të vitit

Pos aktiviteteve të përditshme operacionale, gjatë këtyre muajve kemi pasur këto aktivitete si në vijim :

- Fillimi shqiptar duhet cekur se ndërmarrja ka përfunduar vitin me fitim operativ dhe fitim neto që është me rëndësi të madhe për ekonominë kosovare duke e konsoliduar ndërmarrjen si një organizatë stabile e cila nuk varet nga donacionet apo subvencionet, por gjeneron të hyra të cilat jo vetëm që i mbulojnë shpenzimet por edhe krijon hapësirë për investime vetanake kapitale.
- Drafti final i Raportit të Auditimit për vitin 2022 i cilësuar "i kualifikuar" është një ndryshim pozitiv për dallim nga vitet e kaluara. Gjetja kryesore është mungesa e rivlerësimit të aseteve të ndërmarrjes nga viti 2007. Realisht ky është problemi me të cilin ballafaqohen të gjitha ndërmarrjet publike në shtetin tonë.
- Aktvendimi nga Gjykata Komerciale lidhur me projektin e Bankës Botërore e cila ka aprovuar ankesën e tonë duke e hudhur poshtë aktvendimin e shkallës së parë për caktimin e "Masës së Sigurisë", ku neve nuk na është lejuar e drejta e ekzekutimit të garancioneve të avansit dhe të ekzekutimit, të emëtuara nga Sigal për kompaninë Gener 2. Vlen të theksohet se kjo çështje tani fatkeqësisht është duke u shqyrtuar nga Gjykata e Apelit. Gjithashtu këtu kemi edhe vendimin e favorshëm të DAAB për pretendimet kundër operatorit Gener 2.
- Kompletimi dhe Implementimi i Projektit SCADA si dhe shtrirja e kabllos optike përgjatë kanalit tonë deri te liqeni i Ujmanit.
- Ri-Publikimi i tenderit Mbikqyrjen për projektin "*Mbrojtja e kanalit dhe siguria e ujit*" dhe zbatimi e implemetimi i tij me një përqindje të kënaqshme në terren, Komisioni ka përgjedhur ofertën e operatorit e JV "FAMIS CO" Sh. A. & "KIT-AK GRADNJE" konzorcium kosovaro – slloven në shumë prej 12,875,191.63 €. Afati përfundimin e punimeve është 31.10.2024.
- Refuzimi nga MBPZHR në kërkesën tonë për subvencionim të ujitjes së tokave bujqësore përgjatë kanalit tonë. Kjo na ka shtyrë të komunikojmë me kryetarët e komunave dhe drejtorët e Drejtive të Bujqësisë dhe përfundimisht kemi nënshkruar 4 Marrëveshje Bashkëpunimi për subvencionimin e ujitjes për bujqit në Komunat e Mitrovicës, Prishtinës, Vushtrrisë dhe Obiliqit.
- Ndërkohë kemi themeluar edhe Komisionin për hartimin rregullorës për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes (organogramin) dhe atë të sistematizimit dhe përshkrimit të vendeve të punës, gjë që mund të llogaritet e arritura më e madhe e këtij viti. Jemi duke vazhduar me implementimin e rregulloreve përmes konkurseve të brendshme dhe të jashtme në mënyrë që të përfundojmë procesin e riorganizimit të ndërmarrjes.
- Duhet theksuar që Bordi i Drejtoreve dy herë ka aprovuar dhe ka marrë vendim që të lejohen pakot për dalje vullnetare nga puna në mënyrë që të zbuten pasojat e ristrukturimit me theks të veçantë tek ata të cilët nuk i përbushin kushtet për të u risistematizuar në vendet e reja.
- Përgjedhja nga ana e Bordit të Drejtoreve të Sekretarit / Këshilltarit të Përgjithshëm të ri në ndërmarrjen tonë;
- Punimet në ngritjen e sigurisë në digën e Ujmanit nuk kanë ndaluar asnjëherë dhe kanë vazhduar për të implementuar projektin "*Sistemet e monitorimit të digave*", të cilat përkohësisht u ndërprenë për shkak të situatës së krijuar pas aktit terrorist në Banjskë;

- Kemi arritur që të përfshijmë në bashkëpunim të rregullt stafin tonë në pjesën e veriut ku bënë pjesë HC Ujmani, Diga e madhe e Ujmanit si dhe ajo e Pridvoricës. Gjatë vitit kemi pasur vizita të shumta zyrtare, studimore dhe turistike mbi digën e Ujmanit duke përcuar mesazh të qartë se Ibër-Lepenci është një ndërmarrje e vetme që i përfshin të gjitha asetet e saja dhe i jep përgjegjësi vetëm institucioneve të Republikës së Kosovës.
- Reagimi dhe përgaditja për situata emergjente që e kemi dëshmuar posaçërisht gjatë vërvimeve në muajin Janar. Kjo pastaj rezultoi me rritjen e sigurisë dhe bashkëpunimin me autoritete vendore dhe ato lokale.

#### Takimet:

Gjatë vitit 2023 në vazhdimësi kam mbajtur takime zyrtare me homolog të ndërmarrjeve dhe udhëheqës të Ambasadës Findlandeze, Franceze dhe Izraelite në vendin tonë duke kërkuar bashkëpunim dhe hapjen e ekperiencave dhe mundësive të reja për ndërmarrjen tonë si dhe mundësitë e sigurimit të granteve dhe subvencioneve nga jashtë.

Një interes të veçantë i kam përkushtuar edhe bashkëpunimeve akademike ku me menaxhmentin e Universitetit të UBT, respektivisht rektorin e saj z. Edmond Hajrizin dhe drejtorin për produkte profesionale dhe zhvillimore, z. Besnik Skenderi kemi nenshkruar një memorandum bashkëpunimi në të cilën shpresojmë të rrisim profesionalizimin e stafit tonë me anë të trajnimeve dhe shkollimeve profesionale. Një memorandum bashkëpunimi kam nenshkruar edhe me Fakultetin e Ndërtimtarisë në kuadër të Universitetit të Prishtinës.

- Në këtë drejtim kemi edhe një marrëveshje bashkëpunimi me DBZHR të Komunës së Prishtinës për investim të përbashkët në zgjerimin e rrjetit të ujites,
- Pas shumë qarkullimesh draftesh dhe mosmarreveshjeve kemi arritur te marrëveshja finale me Komunën e Prishtinës rreth çështjes së rrugës "Dëshmorët e Ponoshecit".

Me të marrë detyrën kam organizuar Grupin punues brenda ndërmarrjes, ku kam kërkuar që të hartohet Matrica e Autorizimeve, një dokument shumë i nevojshëm por i cili ka munguar në ndërmarrjen tonë. Ky dokument paraqet përshkrimin e autorizimeve vendimarrëse të zyrtarëve të ndërmarrjes dhe menaxhmentit ekzekutiv të ndërmarrjes lidhur me veprimet operacionale.

#### SFIDAT:

- Një ndër sfidat kryesore ka qenë menaxhimi i kontratës për shitjen e energjisë elektrike operatorit "Fuente Dynamics" për shkak të kontratës tepër të pafavorshme ndaj ndërmarrjes sonë dhe kërkesave të tyre të cilat dëmtonin rëndë ndërmarrjen tonë. Këtu kemi hasur në një mosmirëkuptim edhe nga ana e ZRRE ndaj N.H. „Ibër -Lepenc“ Sh.A., për të shhangur jobalancet, qofshin ato pozitive apo negative.
- Puna në hartimin dhe implementimin e rregulloreve për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes (organogramin) dhe atë të sistematizimit dhe përshkrimit të vendeve të punës ishte sfidë e cila po implementohet me sukses.

Siguria përgjatë kanalit. Në lidhje me ndërmarrjen, sfidat e saj dhe temën mbi rastet me fatalitet në kanalin tonë të emisionit "Udhëve" në RTK, kam paraqitur pikpamjen tonë lidhur me këtë problematikë, cilat janë hapat që presim të i ndërmarrim në të ardhmen e afërt, siç janë vendosja e 7 urave shtesë,

vendosja shtesë e shenjave paralajmëruese dhe mundësia e vendosjes së paneleve solare përgjatë kanalit i cili do të kishte përfitim të shumfishtë pér ndërmarrjen tonë.

**NËNSHKRIMI I MARRËVESHJEVE TË BASHKËPUNIMIT:**

- Kemi nënshkruar 4 Marrëveshje Bashkëpunimi pér subvencionimin e ujitjes pér bujqit në Komunat e Mitrovicës, Prishtinës, Vushtrrisë dhe Obiliqit.
- Kemi nënshkruar Marrëveshjen e bashkëfinancimit me komunën e Prishtinës në vlerë prej 150.000 Euro pér zgjerimin dhe sanimin e rrjetit të ujitjes në komunën e Prishtinës
- Kemi nënshkruar edhe marrëveshje Bashkëpunimi me UBT dhe UP pér të cilën mendoj se mundet me qenë mjaft interesante pér ndërmarrjen tonë nëse dimë ta shfrytëzojmë.
- Kam zhvilluar takim me z. Avni Ahmeti, drejtor i Agjencionit Kadastral të Kosovës, nga i cili kërkova ndihmë në identifikimin e pronave të,, Ibër-Lepencit „, dhe pajisjen me historik të atyre me rëndësi më të veçantë. Pér më tepër, ai caktoi edhe personin përgjegjës i cili do të jetë në çdo moment në dispozicion të ndërmarrjes sonë.
- Kemi nënshkruar marrëveshjen pér të qenë pjesë e Bursës se përbashkët energjetike ALPEX, ku në njëfarë mënyre ka filluar edhe hapja e interesit pér bashkangjitjen e prodhuesve kosovarë të energjisë elektrike në këtë bursë. Kjo mund të llogaritet si një ndër arritjet më të mëdha pér ndërmarrjen tonë në hapjen e tregut të energjisë dhe shitjes së saj në baza ditore dhe në bazë të çmimeve të bursave ndërkombëtare.

Ky raport përbledh të gjitha aktivitetet, arritjet dhe sfidat e NPH “Ibër-Lepenc” Sh.A. pér vitin 2023 duke treguar një progres të qëndrueshëm në shumë fusha operative dhe strategjike të ndërmarmarrjes.

### **3. RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2023 NGA AUDITORI I BRENDSHËM**

Bazuar në Planin Strategjik për auditim të brendshëm për periudhën 2022-2024 dhe Planin Vjetor të auditimit të brendshëm, në kërkesat nga Komisioni i Auditimit, jemi angazhuar në realizimin e objektivave të planifikuara të auditimit të brendshëm për vitin 2023 (raportet e auditimit të brendshëm). Ne jemi fokusuar kryesisht në vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrolleve të brendshme të ndërmarrjes, në zbatimin e kërkesave për pajtueshmëri me ligjet, rregullësi dhe përgatitje dhe prezentim të pasqyrave financiare sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar (SNRF) dhe legjislacionit të aplikueshëm. Për këtë arësyte nga aspekti i auditimit të brendshëm bazuar në vlerësimin tonë të rrezikut, më shumë vëmendje i është kushtuar aktiviteteve ekonomike dhe financiare në implementimin e Planit të biznesit, problematikës së arkëtimit të një pjese të të hyrave e cila po përcjellë në vazhdimësi ndërmarrjen, realizimit të planit të shpenzimeve-shmangëjet (devijimit) nga plani, etj. mirëmbajtja e dosjeve të punësuarëve si dhe në vazhdimësi të verifikimit të implementimeve të rekomandimeve nga raportet e mëhershme të auditimit. Me qëllim të përfitimit të sigurisë së funksionimit të kontrollit të brendshëm, zbatimit të ligjëshmërisë, zbatimit të rregulloreve dhe politikave të brendshme, aplikimit të procedurave përkatëse, realizimit të planit të biznesit, dhe plotësimit të kërkesave ligjore të cilat parashtrohen nga Ligji për ndërmarrjet publike Nr.03/L-087 dhe Ligji Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligji Nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike, kemi ekzaminuar pjesën më të madhe të dokumentacionit relevant, verifikuar përshtashmërinë dhe rregullsinë e funksionimit të sistemeve dhe procedurave dhe në rastet e caktuara kemi vëzhguar zbatimin praktik të procedurave.

Përveç raportimeve mujore dhe tremujore, auditimeve periodike sipas planit të punës për vitin 2023 dhe sipas kërkesave specifike nga ana e Komisionit të Auditimit, monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet paraprake të auditimit, kemi dhënë kontributin tonë këshillëdhënës Menaxhmentit lidhur me çështjet e organizimit, funksionimit më të mirë, të rritjes së nivelit të kontrollit të brendshëm dhe avancimin e procedurave dhe rregulloreve në pajtim me standarde dhe praktikat e mira sa herë është kerkuar vlerësimi jonë. Po ashtu kemi kordinuar bashkëpunimin me audituesit e jashtëm, Zyrën Kombëtare të Auditimit për kryerjen e auditimit të jashtëm të pavarur të pasqyrave financiare për vitin 2022 dhe vitin 2023. Edhe për vitin 2023 auditimin e jashtëm të pavarur të pasqyrave financiare të ndërmarrjes sipas kërkesës nga Ministria e Ekonomisë është duke e kryer Zyra Kombëtare

e Auditimit dhe auditimin e projektit “Siguria e ujit dhe mbrojtja e kanalit” do t’ a kryej kompania e auditimit “Grant Thornton JV” e cila është kontraktuar në fund të vitit 2023.

### Auditimi i brendshëm

Në bazë të Planit Vjetor të auditimit të brendshëm (i cili është përpiluar në bazë të Planit Strategjik 2022-2024 të Auditimit të Brendshëm), vlerësimi tonë për nivelin e rrezikut dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm, gjykimit profesional, duke u bazuar në procedura të auditimit, të vlerësimit, të ekzaminimit, rishikimit dhe vëzhgimit, etj. gjatë vitit 2023 janë audituar ato pjesë të veprimtarisë të planifikuara me Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2023, të cilat i kemi konsideruar se kanë nivel më të lartë të rrezikshmërisë në kuptimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm në arritjen e objektivave të planifikuara të ndërmarrjes, me qëllim të verifikimit të funksionimit, përputhshmërisë dhe zbatimit praktik të rregulloreve të brendshme dhe ligjeve përkatëse, aplikimit të standardeve të kontabilitetit dhe praktikave të mira.

Përmes raporteve të auditimit të brendshëm pas secilit auditim të kryer e kemi njoftuar Komisionin e Auditimit të Bordit të Drejtoreve, Kryeshefin Ekzekutiv, Menaxhmentin dhe njësitë e audituara të ndërmarrjes lidhur me të gjeturat gjatë auditimit, me rekomandimet si dhe kemi pranuar planet e veprimit nga Menaxhmenti për implementimin e tyre. Gjithashtu kemi ndërmarrë aktivitete të monitorimit të implementimit të rekomandimeve nga auditimet e kryera më parë. Edhe këtë vit në vazhdimësi të shërbimit tonë si ndihmesë Menaxhmentit të ndërmarrjes, duke pasur synim veprimin parandalues (preventiv) të auditimit të brendshëm, kemi bërë përpjekje që të japim kontributin tonë edhe në proceset dhe rrjedhat tjera të rëndësishme të afarizmit të ndërmarrjes kur është kërkuar opinioni jonë, por edhe për çështje të cilat i kemi trajtuar si të paraportueshme në raportet e auditimit.

Sipas Planit vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2023 janë kryer auditimet si vijon:

1. Arkëtimi i të hyrave nga jobalance nga shitja e energjisë;
2. Funksionimi i kontolleve të brendshme për vijueshmërinë në punë, pagesat për punë jashtë orarit dhe punë gjatë natës;
3. Llogarita e përvojës së punës për të punësuarit;
4. Kompensimet për taksat për rregulatorin;
5. Pagesat nga ndërmarrja për tjerët (shpenzimeve, obligimeve tatimore dhe obligimeve tjera);
6. Realizimi i investimeve kapitale të planifikuara.

Me qëllim të informimit të Komisionit të Auditimit me afarizmin e ndërmarrjes, rrjedhat operative dhe financiare, rrjedhën e parasë, arkëtimet, likuiditetin, aktivitetet e prokurimit, para çdo takimi mujor të Komisionit të Auditimit kemi përgaditur raporte pune mujore dhe tremujore për periudhat përkatëse për vitin 2023. Përveç detyrave të auditimit të planifikuara me planin vjetor të punës, ka pasur edhe kërkesë specifike nga Komisioni i Auditimit për auditim shtesë jashtë Planit Vjetor të Auditimit të Brendshëm. Bazuar në Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm 2022-2024, vlerësimin tonë të rezikut, gjykimin profesional, frekuentimit të detyrave audituese, të mundësisë të mospërfshirjes të ndonjë prej tyre, etj. është përpiluar Plani vjetor i punës së auditimit të brendshëm për vitin 2024 i cili pasi është shqyrtaur është aprovuar nga Komisioni i Auditimit.

*Në vazhdim në formë tabelare janë parqitur auditimet e brendshme të planifikuara dhe të kryera gjatë vitit 2023:*

Nr.	Nr. i planifikuar i auditimit	Emërtimi i auditimit	Me kërkesë të KA	Planifikuar	Të kryera	Vërejtje
1	001/2023	Nj.A.-Uji dhe Gjenerimi dhe Sektori llogaritar-i financave dhe kontabilitetit - 1. Arkëtimi i të hyrave nga jobalancet nga shitja e energjisë	JO	PO	PO	
2	002/2023	Burimet njerëzore, Sektori llogaritar-i financave dhe kontabilitetit 2. Funksionimi i kontrolleve të brendshme për vijueshmërinë në punë, pagesat për punë jashtë orarit dhe punë nate	PO	JO	PO	
3	003/2023	Burimet njerëzore 3. Llogaritja e përvjohës së punës për të punësuarit	PO	JO	PO	
4	004/2023	Njësia Afariste Uji dhe Gjenerimi dhe Sektori llogaritar-i financave dhe	JO	PO	PO	

		kontabilitetit: 4. Kompensimet për taksat për rregulatorin				
5	005/2023	Sektori llogaritar-i financave dhe kontabilitet 5. Pagesat nga ndërmarrja për tjerët (shpenzimeve, obligimeve tatimore dhe obligimeve tjera)	JO	PO	PO	
6	006/2023	Departamenti i Prokurimit, Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim 6. Realizimi i investimeve kapitale të planifikuara nga burimet vetanake	JO	PO	Projekte te inicuara te cilat vazhdojne implementimin	

Pasqyra e auditimeve të kryera gjatë vitit 2023 me të gjeturat dhe rekomandimet (të zbatuara, në process dhe të pazbatuara):

Auditime të kryera gjatë vitit 2023	Të gjetura	Rekomandime	Të zbatuara	Në proces	Të pazbatuara
Arkëtimi i të hyrave nga jobalanceet nga shitja e energjisë	2	3	1	2	0
Funksionimi i kontrolleve të brendshme për vijueshmërinë në punë, pagesat për punë jashtë orarit dhe punë nate	3	3	2	1	0
Llogaritja e përvojës së punës për të punësuarit	0	0	0	0	0
Kompensimet për taksat për rregulatorin	1	1	1	0	0
Pagesat nga ndërmarrja për tjerët (shpenzimeve, obligimeve tatimore dhe obligimeve tjera)	3	3	3	0	0
Realizimi i investimeve kapitale të planifikuara nga burimet vetanake	3	3	0	3	0
Gjithsej:	12	13	7	6	0

**Të gjeturat, klasifikimi, rekomandimet, komentet e Menaxhmentit, statusi i të gjeturave për Raportet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023**

Detyra audituese-TË GJETURAT	KLASIFIKIMI I TË GJETURAVE	REKOMANDIMET	KOMENTET E MENAXHMENTIT	STATUSI
2	3	4	5	6
<b>01/2023- Arkëtimi i të hyrave nga jobalancet nga shitja e energjisë</b>				
Ka vonesa në arkëtimin e të hyrave nga jobalancet e shitjes së energjisë.	E rëndësisë së lartë	Të dërgohen leter-kujtesa për nivelin e lartë të kërkesave të paarkëtuara.	Rekomandimi pranohet	Në proces
Nuk janë respektuar afatet e pagesave sipas Rregullave të Tregut	E rëndësisë së lartë	Të dërgohen shkresa zyrtare ku theksohet se për vonesa do të zbatohet neni 18.3.4 I Rregullave të Tregut _PO-MO-001, ver.3.0, llogaritja e kamates prej 4.5% sipas Ligjit për Marrëdhënje Detyrimore.	Rekomandimi pranohet	Në proces
		Të kërkohet të paguhen të gjitha kërkesat e paarkëtuara fillimisht deri më 31.12.2022	Rekomandimi pranohet	E kryer
<b>02/2023- Funksionimi i kontrolleve të brendshme për vijueshmërinë në punë, pagesat për punë jashtë orarit dhe punë nate</b>				

Vijueshmeria në punë-funksionimi formal i pajisjes së evidentimit të hyrje-daljeve	E rëndësisë së mesme	Kërkesat për angazhim në ore shtesë pertej orarit të rregulltë të punës dhe pastaj shpërblimet duhet të plotësohen paraprakisht (para ndodhjes së veprimit) dhe të arësyetohen para se të dërgohen për aprnvim te KE.	Rekomandimi pranohet	E kryer
Mungesa e vendimit për orët shtesë përtëj orarit të rregulltë	E rëndësisë së mesme	Të përpilohet një rregullore e brendshme në lidhje me plotësimin, nënshkrimin, dërgimin në aprovim të orëve të punës.	Rekomandimi pranohet	Në proces
Angazhimi i të punësuarëve me gjatë se sa orari i plotë i punës	E rëndësisë së mesme	Të shqyrtohen mundësitë për minimizimin e punës më të gjatë se orari i plotë i punës në lidhje me dispozitat e Ligjit të punës, nen 23, pika 2 dhe pika 3.	Rekomandimi pranohet	E kryer
<b>03/2023 - Llogaritja e përvojës së punës për të punësuarit</b>	E rëndësisë së mesme			
<b>04/2023 Kompensimet për taksat për rregulatorin</b>				
Ka pasur vonesa në pagesat e kryera për tarifa	E rëndësisë së mesme	Perpilimi i një përkujtuesi të afateve për pagesën e tarifave dhe taksave që do të mundësonte përgaditjen dhe pastaj pagesën sipas afatit të caktuar.	Rekomandimi pranohet	E kryer
<b>05/2023</b>				

<b>Pagesat nga ndërmarrja pér tjerët (shpenzimeve, obligimeve tatimore dhe obligimeve tjera)</b>				
Moszbatimi njëjtë i praktikës së mirë	E rëndësisë së ulët	Edhe faturat e përmendura të gjetjet mund të vërtetohen-konfirmohen nga Drejtori i Departamentit të Administratës pér selinë e ndërmarrjes dhe nga udhëheqësitë e NJP-Shkabaj, Komoran dhe Vushtri ose të caktohet një përsone tjetër.	Rekomandimi pranohet	Në vazhdimsi
Në disa fatura plotësohet vetëm nënshkrimi pa shenimin e emrit dhe mbiemrit	E rëndësisë së mesme	Nga personat që vërtetojnë faturat-kryerjen e sherbimeve ose furnizimeve të shënohet emri dhe mbiemri para ose pas nënshkrimit sepse nga disa nënshkrimet nuk mund të kuptohet a është nënshkruar nga personat e autorizuar-kompetent.	Rekomandimi pranohet	Në vazhdimsi
Pranimi i faturave në të cilat afati i pagesës ndryshon nga afati i kontraktuar	E rëndësisë së mesme	Nga Menaxhmenti të ndërmerren veprime pér njoftimin e furnitorëve që të bëjnë korigjimin e faturave të cilat janë të plotësuara në kundërshtim me kushtet e kontratës ose me gjendjen faktike.	Rekomandimi pranohet	Në vazhdimsi
<b>06/2023 - Realizimi i investimeve</b>				

<b>kapitale të planifikuara nga burimet vetanake</b>				
Mosinicimi i procedurave për fillimin e realizimit të disa projekteve kapitale	E rëndësisë së mesme	Vendosja nga ana e Njësisë së kërkesës e një afati orientues të fillimit dhe një afati (pritjet) kur ai mund të përfundoje (nëse është njëvjeçar apo disa vjeçar-projeksioni) te përshkrimi i projektit në Planin e Biznesi		Në proces
Mosrealizimi i projekteve në vitin e planifikuar dhe bartja në vitin tjetër	E rëndësisë së mesme	Menaxhmenti-Njësitë e kërkesës bazuar në datën e planifikuar në Planin e biznesit duhet kërkuar nga Zyra e Prokurimit përmes shkresës zyrtare (bashkengjitur dokumentacionin e specifikimeve teknike) inicimin e procedurave të prokurimit.		Në proces
Vonesat në përgaditjen e specifikimeve për realizimin e projektit	E rëndësisë së mesme	Nga Menaxhmenti-Njësitë e kërkesës të planifikohet se projektet-aktivitetet e planifikuara me Plan të Biznesit për vitin aktual duhet të përfundojne deri në fund të vitit për të cilin janë planifikuar që të mos barten në vitin vijues perveç projekteve disavjeçare.		Në proces

## 4. TË HYRAT NGA UJI DHE GJENERIMI


### Departamenti „Uji dhe Gjenerimi ”- 2023

Gjatë vitit 2023 kjo njësi i ka përmbushur në tërësi obligimet që kanë qenë të parapara me plan përfurnizim me ujë të papërpunuar përfshirë gjithë shfrytëzuesit nga sistemi IL. Gjatë sezonit së ujitjes, janë siguruar sasi të nevojshme të ujit përshtatzësuar nga sistemi e kanaleve, objekteve ndarëse si dhe stacioneve pompikë të shtësia e mundur që furnizimi të jetë me kohë cilësi dhe sasi të duhur. Kurse sa i përket furnizimit me ujë përfshirë ujite në S.P. Besi shtëpunuar gjithsej 729 orë apo janë shtyrë në sistem **2,886,840.00 m<sup>3</sup>** ujë, ndërsa në S.P. Bivolak shtëpunuar gjithsej 171.6 orë apo janë shtyrë në sistem **803,292.75 m<sup>3</sup>** ujë. Gjatë vitit 2023 në Hidrocentralin i Ujmanit janë gjeneruar **147,291.07 MWh**, dhe janë injektuar/plasur në sistemin transmetues. Pas kalkulimit të humbjeve (koficienti i humbjes, matja e KOSTT-it) **145,291.07 MWh**. Përfshirë së siguruar vazhdimesin operative dhe atë financiare, operatorit ekonomik i shtësia liferuar vetëm minimumi vjetor kontraktual **40,048.00MWh**.

Sipas kërkesave të shfrytëzuesve të ujit nga sistemi i IL-it gjatë vitit 2023 janë distribuuar këto sasi të ujit, gjithëses **59,074,212 m<sup>3</sup>** apo të përshkrura nëpërmjet formës tabelare si në tabelë :


2023	<b>m<sup>3</sup></b>
<b>KRU Mitrovicë</b>	<b>20,536,374</b>
<b>KRU Mitrovicë ( Vushtrri)</b>	<b>7,519,224</b>
<b>KUR Prishtina(Shkabaj)</b>	<b>14,222,220</b>
<b>KUR Prishtina(Drenas)</b>	<b>3,192,377</b>
<b>NewCo Ferronikel CoL.L.C</b>	<b>1,920,217</b>
<b>KOSOVA A</b>	<b>646,200</b>
<b>KOSOVA B</b>	<b>11,037,600</b>
<b>Totali</b>	<b>59,074,212</b>

## Sasitë e distribuara të ujit nga Hidrosistemi për shfrytezuesit gjatë vitit 2023




Në këtë tabelë janë paraqitur sasitë e distribuara të ujit ndër vite 2021-2023

## Sasite e distribuara te ujit per gjate viteve 2021-2023




Duke pasur parasysh nivelin e ujit në liqe dhe prurjet në HC janë gjeneruar **147,289.29 MWh**, apo **77.46 %** me shumë sasitë se e planifikuara edhe me rishikimin e Planit të biznesit (**83,000.00 MWh**), si pasojë e prurjeve enorme gjatë këtij viti 2023.

Diagrami i gjenerimit të energjisë elektrike për vitin 2023




### Krahasimi i gjenerimit nga HC ndër vitet 2016-2023




Prurjet mesatare të ujit në akumulimin në Ujëman gjatë vitit 2023 kanë qenë **20.15 m<sup>3</sup> / s**, që do të thotë se kemi pasur prurje shumë herë me të mëdha se me prurjet mesatare vjetore, (**13,05 m<sup>3</sup> / s**) që është marrë si bazë për projektimin e sistemit dhe të kapacitetit gjenerues të HC Ujman, vlenë të theksohet se kemi pasur një trend të shpejtë të rritjes së prurjeve gjatë muajit prill(33.5) dhe muajit qershor (36.1)

Prurjet mesatare për vitin 2023



**Prurjet gjatë viteve për gjatë viteve 2016-2023**




Muajt/vitet	Prurjet gjatë viteve m <sup>3</sup> /sec							
	2023	2022	2021	2020	2019	2018	2017	2016
Janar	32.1	8.4	23.88	5.3	5.6	8	4.5	7.1
Shkurt	18.5	12.7	39.19	10.9	20.03	21.1	18.2	16.9
Mars	23.1	13.3	20.92	21.8	22.14	36.3	25.2	31.8
Prill	33.5	26.1	38.40	13.6	18.7	26.7	21.4	22.6
Maj	23.8	16.8	26.15	9.19	17.2	21.2	20.7	26.3
Qershor	36.1	6.8	10.17	11.05	27.4	24	14.1	13.2
Korrik	11.5	3.9	6.05	7.3	9.3	22.5	6.4	6.7
Gusht	5.2	5.1	5.12	11.4	9.02	11.8	5.7	7.9
Shtator	8.4	8.8	4.07	7.2	4.9	5.4	3	13.5
Tetor	5.3	5.8	4.60	10.17	3.4	5.32	3.3	9.3
Nentor	19.6	26.6	2.80	4.5	6.5	3.5	8.4	31.1
Dhjetor	24.7	28.5	11.70	12.9	10.3	6.12	14.1	5.3

Niveli i ujit në akumulim me 1 janar 2023 ka qenë në kuotën 688.19 m (328 mil. m<sup>3</sup>, shkalla 38.5), ndërsa me 31 dhjetor 2023 niveli ka qenë në kuotën 685.38 m (302 mil. m<sup>3</sup>, shkalla 53).


Në grafikonin e më poshtëm është paraqitur sasia e ujit(mil. m<sup>3</sup>) në fillim të çdo muajit.

## Niveli i akumulimit në pendën e "Ujëman" për 2023



	280,000,000	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Totor	Nentor	Dhjetor
mil.m3	328,422,186	342,506,716	340,724,855	328,422,186	326,597,237	315,688,568	303,170,132	312,071,240	302,261,042	303,170,132	312,071,240	302,261,042	

### Ditet dhe muajit dhe Vëllimi i ujut në mil. m<sup>3</sup> gjatë vitit 2023



Ditet e muajit dhe Vëllimi e ujit në mil. m<sup>3</sup>

**Njësia Afariste "Ujitja" për vitin 2023** me të tri Njësit Punuese në Vushtrri, Shkabaj dhe Komoran - ka vazhduar aktivitetet e rregullta në kryerjen e detyrave dhe punëve që dalin nga Plani i biznesit për këtë vit, konform rrrethanave dhe kushteve atmosferike të krijuara gjatë tërë vitit 2023, ka ndërmarr të gjitha veprimet e duhura për mbarëvajtjen e procesit të ujitjes. Bazuar edhe në Planin e Biznesit, me kohë kemi filluar përgatitjen e sistemit për fillimin e mbarë të sezonit të ri të ujitjes. Kjo njësi gjatë vitit 2023 ka mbajtur disa takime me faktorët relevant për zhvillimin e bujqësisë siç janë: Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e Bujqësisë në komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Obiliq, Prishtinë dhe Drenas me shoqatat e fermerëve si dhe me fermerët individual. Takime sipas nevojës kemi mbajtur edhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe kompanitë punëkryerëse për shkak të problemeve që kanë dalë gjatë ndërtimit të rrugëve magjistrale e të cilat e kanë atakuari sistemin e ujitjes. Që sezon i ujitjes të fillojë më kohë dhe furnizimi më ujë të jetë sa më i mirë dhe i sigurt, kemi ndërmarrë veprimet e duhura në tre drejtime:

- **Kampanja-** Informimi i fermerëve për fillimin e sezonit të ujitjes.
- **Kontraktimi** i sipërfaqeve për ujitje.
- **Përgatitja teknike e sistemit** (reabilitimi i të gjitha defekteve në sistem).
- **Kampanja:** sipas planifikimit është bërë informimi i fermerëve për kohën e fillimit të furnizimit më ujë, për ujitjen e tokave bujqësore dhe mundësitet e N.H., „Ibër-Lepenc” përfshirë furnizimin e fermerëve më ujë.

Informimi është bërë përmes mjeteve të shkruara dhe elektronike nëpërmjet rrjetave sociale, si dhe nga punëtoret e terenit, më biseda të drejtpërdrejta më fermerët.

Menaxheri i Nj.A.”Ujitja,, se bashku me Udhëheqësit e Njësive Punuese ka organizuar takime/komunikime më drejtoratët e Bujqësisë nëpër komuna, takime si dhe takimet e drejtpërdrejta më fermerët. Në këto takime/komunikime janë diskutuar problemet e përbashkëta rrëth ujitjes së kulturave bujqësore, gjendja teknike e sistemit të ujitjes si dhe probleme tjera që kanë të bëjnë me kushtet dhe nivelin e zhvillimit te fermerëve.

- **Kontraktimi:** Kontraktimi i sipërfaqeve për ujitje kryesisht behet në zyrat e Njësive Punuese, mirëpo për lehtësimin e kësaj procedure dhe që fermerëve t'u bëhet sa me i lehtë kontraktimi i ujitjes, teknikët e ujitjes dalin në terren dhe shtëpitë e fermerëve ku bëjnë kontraktimin e sipërfaqeve për ujitje. Gjatë vitit 2023 janë ujitur gjithsejtë **1386.33** hektar.

- **Përgatitja teknike e sistemit:** fillimisht janë bërë vizitat në terren është vlerësuar gjendja teknike e sistemit duke u bazuar në kërkësat e fermerve për ujitje, janë vendosur priorititet për rehabilitimin dhe aftësimin e sistemit për fillimin e sezonit të ri të ujitjes. Në këtë drejtim bazuar në Planin e biznesit është bërë riaftësimi i pjesëve të parapara të sistemit duke përfshirë: gypat, komplet fazoneria, deri tek hidranti.

Sistemi i ujitjes gjatë vitit 2023 ka qenë i rehabilituar në rrëth 11,000 ha, pra mundësitet për ujitje kanë qenë në 11,000 ha të tokave bujqësore ku shtrihet sistemi i “Iber-Lepenc”.

- **Mirëmbajtja e sistemit të ujitjes:** Punëtorët e të tre Njësive Punuese, gjatë sezonit të Ujitjes 2023, kanë bërë një punë të madhe në mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes, si dhe rehabilitimin e rrjetit nëntokësor të gypave (ndërrimi i gypave të dëmtuar, ndërrimi gjegjësisht vendosja e fazonesisë së re, nëpër puseta, përpunimi i hidrantëve etj), ku si rezultat e kësaj mirëmbajtje të rregullt nuk kemi pasur asnje nderprerje të ujitjes gjatë sezonit të ujitjes 2023.

Në vazhdim me foto po paraqesim disa aktivitete të Nj.A. „Ujitja” së bashku më tri Njësitë Punuese gjatë sezonit të ujitjes në vitin 2023.



Foto 1. Sanimi i gypit Ø 700 Korroticë e poshtëm Foto 2. Ndërrimi i gypit Ø 700 në fshatin Vërnice,



Foto 3. Vendosja e Lidhëses riparuese në tubacion, Foto 4. Largimi i shkurreve përgjatë kanalit të hapur



Foto 5. dhe 6. Pastrimi i ujemarrësve (para hyrjes se ujit në gypin kryesore)



Foto 7. Lubrifikimi i mekanizmit të portës tubacionit

Foto 8. Pastrimi i Grilës në hyrje të tubacionit



Foto 9. dhe 10. Ujitja e Kulturave Bujqësore-Patare dhe Misër



Foto 11 dhe 12. Ujitja e Kulturave Bujqësore-Lakër dhe Patate

Të gjitha këto aktivitete të ndërmarra gjatë sezonit të ujitjes të koordinuara mirë nga menaxhmenti i Ndërmarrjes kanë bërë të mundur që gjatë sezonit të ujitjes të mos ketë asnje ndërprerje të ujitjes si pasojë e problemeve teknike në sistemin e ujitjes.

#### -Ujitja:

Kontraktimi i sipërfaqeve për ujitje ka filluar qe nga muaj Maj dhe ka vazhduar deri ne fundin e muajt Qershor. Të reshura vazhdueshme të shiut, gjatë muajit Qershor dhe Korrik, kanë bërë që kontraktimi i sipërfaqeve të ujitës të mos jetë në nivelin e duhur. Përkundër se, ne me kohë kemi funksionalizuar sistemin e ujitjes në mënyrë që të jetë sa më afër nevojave të bujqëve, situata e vazhdueshme e reshorave ka bërë që fermerët të mos furnizohen me ujë për të mbjellat e tyre. Sezoni i ujitjes ka filluar me kohë, në baze të kërkesës se fermerëve. Sistemi është mbushur me uji në baze të përshkrimeve teknike dhe në mënyrë profesionale pa pasur asnje avari. Punëtoret në teren janë kujdesur për mbarëvajtjen e ujitjes si në kuptimin cilësor ashtu

edhe ne atë sasior gjatë tërë sezonit të ujitjes. Shtypja e ujit nëpër Hidranta është mbajtur brenda kritereve të rregullores për shfrytëzimin e sistemi të ujitjes, që do të thotë se shtypja në hidranta ka qenë 2.5 – 5 bar. Me kërkësën e fermerëve dhe aprovimin e Bordit të Drejtoreve ujitja ka vazhduar edhe gjatë muajit Tetor.

Gjatë sezonit të ujitjes, tekniket e meliorimeve kanë bërë evidentimin e sipërfaqeve të ujitura dhe kanë konstatuar përputhshmërinë e kontratës për ujitje më sipërfaqen e ujitur. Kemi pasur relativisht defekte, duke përfshirë dëmtimin e gypave dhe fazonerisë, por fale ndërhyrjeve të shpejta të ekipeve në terren këto defekte nuk kanë ndikuar në vonesa apo cilësinë e ujitjes. Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me fermerët si dhe përkrahja e tyre nga institucionet shtetore, në zhvillimin dhe modernizimin e fermave, vlerësojmë se do të ndikojë në ngritjen e sipërfaqeve të ujitura.


Me Planin e Biznesit të vitit 2023, kemi paraparë që fermerët mund të ujisnin rrëth 1300 ha, por si rezultat i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit ndërmjet N.H. "Iber-Lepenc" dhe komunave Vushtrri, Obiliq, Prishtinë dhe Mitorivcë si dhe kushteve atmosferike, fermerët e kanë shfrytëzuar ujin për ujitjen e kulturave bujqësore për 1368.33 Ha, e që në përqindje i bie se plani i ujitjes është tejkaluar rrëth 5%.

Më poshtë në mënyrë tabelare po paraqesim sipërfaqet e planifikuara për vitin 2023 dhe ato të ujitura nga viti 2020 deri më 2023.

**Tab.1 Sipërfaqet e ujitura 2020-2023 dhe ato të planifikuara për vitin 2023**

